



---

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AKADEMIA E SHKENCAVE**

**Tiranë, më 5.5.2026**

**Njoftim për pozicion të lirë pune**

Në zbatim të ligjit nr. 53/2019 “Për Akademinë e Shkencave në Republikën e Shqipërisë”, të Statutit të saj, të vendimit nr. 35/2020 datë 09.07.2020 të Kuvendit të Shqipërisë “Për strukturën dhe organikën në Akademinë e Shkencave”, i ndryshuar dhe të Rregullores së brendshme administrative të Akademisë së Shkencave, të ndryshuar, shpallet vendi i lirë:

**A. Pozicionin koordinator kërkimor-shkencor, kategoria III-3.**

Pozicioni i punës është pranë *Qendrës së projekteve dhe koordinimit të kërkimit shkencor* në Akademinë e Shkencave të Shqipërisë.

**B. Fushat mbi të cilat do të bazohet konkurrimi si dhe aftësitë që do të vlerësohen në konkurrim.**

- Fusha e aplikimit në projektet kërkimore-shkencore kombëtare, dypalëshe, rajonale, të Bashkimit Europian dhe të atyre ndërkombëtare; si dhe ato të agjencive të tjera shtetërore apo private, brenda apo jashtë vendit;
- Njohuri specifike mbi projektet *Horizon 2020, Coast Acting, Erasmus* etj.
- Legjisllacioni kombëtar për shkencën, për Akademinë e Shkencave dhe për arsimin e lartë, veçmas për çështje që lidhen me kërkimin shkencor dhe projektet e kërkimit, të drejtat dhe detyrimet;
- Aktet ligjore dhe nënligjore të BE për fushën e projekteve dhe aplikimeve për projekte.
- Kodi i etikës në kërkimin shkencor.
- Ligji 53/2019 *Për Akademinë e Shkencave në Republikën e Shqipërisë*, detyrimet dhe të drejtat që burojnë prej tij, për punonjësit e kësaj qendre.
- Standardet e shkrimit akademik në hartimin e dokumentacionit të fushës.

## **C. Kriteret e përgjithshme dhe specifike:**

### **C-I. Të përgjithshme:**

- a) Të jetë shtetas shqiptar;
- b) Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- c) Të zotërojë gjuhën e njësuar shqipe, me shkrim e të folur;
- d) Të jetë në kushte shëndetësore të mira, që lejojnë të kryejë detyrën përkatëse;
- e) Të plotësojë kriteret specifike të vendosura në bazë të përshkrimit të vendit të punës për formimin, kualifikimin, përvojën etj.;
- f) Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale që përbën pengesë ligjore;
- g) Të mos ketë masë disiplinore për largim nga detyra apo që nuk është parashkruar;
- h) Të mos ketë masë ndëshkimore në fuqi, nga komisionet e etikës, për shkelje të kodit të kërkuesit shkencor ose mësimdhënësit;
- i) Të jetë a të vendoset me banim në Tiranë.

### **C-II. Krite të domosdoshme dhe specifike:**

#### a) Krite të domosdoshme

- Të ketë përfunduar studimet e shkallës së dytë në nivelin Master shkencor (DND);
- Të ketë mbaruar studimet universitare me notë mesatare mbi 8;
- Të njohë shumë mirë gjuhën angleze në nivelin C1 (të certifikuara);
- Të ketë përvojë të dokumentuar mbi 5 vjet për hartimin e dokumentacionit dhe përgatitjen e projekteve kombëtare dhe ndërkombëtare.

#### b) Krite specifike:

- Të ketë aftësi të mira kompjuterike dhe veçmas në aplikimin e programeve Word dhe Excel (të certifikuara);
- Njohja e një gjuhe të dytë të vendeve të BE-së përbën përparësi.

## **Ç. Dokumentet dhe afati i dorëzimit**

*Dokumentet që duhet të paraqesë kandidati: Kandidati duhet të dërgojë me postë ose dorazi në një zarf të mbyllur pranë zyrës së protokollit dokumentet e dosjes së tij personale si më poshtë:*

1. *Kërkesën me shkrim;*
2. *Curriculum Vitae;*
3. *Fotokopje e faqes së parë të pasaportës ose të kartës së identitetit;*
4. *Diplomën/at universitare dhe listën e notave, të noterizuara;*
5. *Fotokopje e librezës së punës (për të vërtetuar përvojën e punës);*
6. *Vërtetimin e zotërimit të gjuhës së huaj;*
7. *Vërtetimi i gjendjes shëndetësore (origjinal);*
8. *Vërtetimin e gjendjes gjyqësore;*
9. *Vërtetim ose vetëdeklarim që nuk ka masë disiplinore në fuqi;*

10. Diploma dhe vlerësime të fituara në punë, shoqëruar me të paktën dy rekomandime.

### **Afati i dorëzimit të dokumenteve:**

Pranimi i dokumenteve bëhet deri me datën 15.5.2026 ora 12:00. Gjatë kësaj periudhe kandidatët kanë të drejtën të konsultohen me njësinë përgjegjëse të personelit për plotësimin e dokumentacionit. Pas këtij afati nuk pranohet asnjë aplikim për këtë vend pune.

### **D. Fazat e konkurrimit dhe mënyra e vlerësimit të aftësive dhe cilësive të konkurrentëve që do të paraqiten në garë.**

#### **Fazat e konkurrimit:**

Konkurrimi zhvillohet në dy faza:

- a) Verifikimi paraprak i plotësimit të kriterëve të përgjithshme dhe specifike të domosdoshme prej kandidatëve;
- b) Vlerësimi i kandidatëve. Njësia përgjegjëse, në bazë të dokumentacionit të paraqitur nga kandidatët, brenda 7 ditëve nga mbyllja e këtij procesi, bën verifikimin e plotësimit të kriterëve të përgjithshme e specifike të domosdoshme prej kandidatëve. Ndërsa komisioni i pranimi të personelit (KPP) bën vlerësimin e kandidatëve që i plotësojnë këto kriterë.

#### **Mënyra e vlerësimit:**

Vlerësimi i kandidatit/ëve që kualifikohet/en për më tej, do të bëhet në datën 1.6.2026, prej orës 11:00.

Vlerësimi do të bëhet për: a) Arsimimin, kualifikimin e aktivitetin e kandidatëve, mbështetur në dokumentacionin e depozituar në dosje; b) Intervistën me gojë; c) Pyetësorin me shkrim. Totali i pikëve në vlerësimin e kandidatëve është 100 (njëqind) pikë dhe ka këtë strukturë: a) 15-25 % për formimin profesional; b) 20-30 % për vlerësimin në bashkëbisedimin me gojë; c) 45-55 % për vlerësimin me shkrim.

### **E. Shpallja e rezultateve dhe njoftimi i fituesit**

#### *Verifikimi paraprak*

*Rezultatet e verifikimit paraprak të kryer nga njësia, me emrat e kandidatëve që i plotësojnë kriteret, do të shpallen në faqen zyrtare të Akademisë së Shkencave dhe në portalin e Shërbimit Kombëtar të Punësimit. Lista e kandidatëve që nuk kualifikohen nuk publikohet. Njësia i bën të ditur çdo kandidati veçmas arsyen e moskualifikimit. Ankesat nga kandidatët paraqiten në njësinë përgjegjëse brenda 3 (tri) ditë pune nga shpallja e listës dhe ankuesi merr përgjigje brenda 3 (tri) ditë pune nga data e depozitimit të saj.*

### ***Verifikimi i kandidatëve***

Kandidatët e kualifikuar duhet të paraqiten më datën 1.6.2026 për zhvillimin e konkursit me shkrim e me gojë pranë KPP. Rezultati për çdo kandidat do të dalë nga shuma e pikëve të dhëna për të nga anëtarët e KPP. Në bazë të tyre do të përcaktohet renditja e kandidatëve.

Lista me emrat e konkurruesve me mbi 65 pikë do t'i dërgohet njësisë përgjegjëse të personelit e cila *shpall fitues të parin që renditet në listë*. Emri dhe profili profesional i fituesit *i njoftohen Kryesisë*. Kryetari i ASH bën emërimin në detyrë të fituesit. Fituesi brenda tre ditësh lidh kontratën e punës me institucionin të përfaqësuar nga sekretari shkencor i ASH.

Njësia bën publik vendimin për emërimin përmes faqes zyrtare dhe rrjeteve sociale të institucionit.

**Akademia e Shkencave e Shqipërisë**

**[www.akad.gov.al](http://www.akad.gov.al)**

**NJËSIA PËRGJEGJËSE PËR PERSONELIN**

**Përshkrimi i punës:**  
**Koordinator i projekteve**

**Koordinatori i projekteve në Akademinë e Shkencave vepron në përputhje me ligjin nr. 53/2019 Për Akademinë e Shkencave në Republikën e Shqipërisë, me aktet e miratuara në zbatim të tij, dhe rregulloret e brendshme të institucionit.**

- ndjek ofertat nga institucionet përkatëse e institutet ndërkombëtare, propozimet për projekte dhe përgatit dokumentacionin për propozimin e tyre pranë seksioneve e Kryesisë, si dhe ndjek aplikimin e zbatimin e tyre në rast sukcesi;
- krijon një evidencë të të gjitha fushave të kërkimit shkencor në të cilat angazhohen strukturat e ASH-së, të qendrave të kërkimit shkencor pranë institucioneve të arsimit të lartë, të qendrave të tjera të pavarura të kërkimit shkencor brenda vendit dhe për objektin e kërkimit të tyre;
- evidenton interesat që kanë qendrat e kërkimit shkencor për bashkëpunim, koordinon veprimtarinë e tyre dhe ia bën ato të ditura drejtorit e Kryesisë;
- ndjek marrëdhëniet e ASH-së me qendrat e kërkimit brenda dhe jashtë vendit;
- përgatit nënshkrimin e marrëveshjeve të bashkëpunimit mes Akademisë së Shkencave me qendrat e kërkimit shkencor pranë institucioneve të arsimit të lartë dhe me akademitë homologe jashtë vendit e institucionet ndërkombëtare për fushat dhe çështjet me interes shkencor të ndërsjellë, si dhe bën propozimet për zgjerimin apo rivlerësimin e tyre;
- u sugjeron mbështetje kërkuesve të rinj për titujt dhe gradat shkencore, duke rekomanduar udhëheqës shkencorë të njësive të ASH-së;
- krijon, administron dhe ruan dokumentacionin e veprimtarisë, marrëveshjeve të bashkëpunimit, propozimet e koordinimit apo kërkimit shkencor etj. të drejtorisë;
- koordinon, ndjek me dinamikë dhe bashkëpunon në fushën e projekteve kërkimoshkencore të ofruara nga KE-ja dhe agjenci të tjera shtetërore apo private, brenda ose jashtë vendit, punën për përfshirjen e ASH-së në këto projekte;
- përgatit në fillim të çdo viti “Listat me fushat konkrete të aplikimit për projekte”, që ofrojnë programet e ofruara nga KE-ja dhe programe të tjera për njësitë dhe kërkuesit shkencorë të ASH-së;
- bashkëpunon dhe ndjek në vazhdimësi punën me njësitë dhe kërkuesit shkencorë të ASH-së për plotësimin e dokumentacionit dhe dosjeve përkatëse për projektet e aplikuar prej tyre;
- jep mendime me shkrim për drejtuesin e drejtorisë, për pjesëmarrje ose jo, për propozimet e ardhura për partneritet apo pjesëmarrje në projekte, të fituara nga ASH-ja apo qendra të kërkimit shkencor, brenda dhe jashtë vendit;
- u propozon njësive të ASH-së vlerësimin e projekteve të reja dhe u sugjeron atyre aplikimin për pjesëmarrje në to;
- raporton në mënyrë periodike për dinamikën dhe ecurinë e projekteve në të cilat është aplikuar, në rolin e drejtuesit apo të partnerëve, për realizimet e suksesshme të projekteve;
- ruan dhe administron dokumentacionin e krijuar në fushën e projekteve;
- bashkëpunon ngushtësisht me sektorët e administratës për mbështetjen në realizimin e detyrave;
- kryen me përgjegjësi çdo detyrë tjetër që i ngarkohet.